



Njoftim/Thirrje
KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
“NDRYSHIMET KLIMATIKE, RESURSET UJORE DHE
TRAJTIMI I UJËRAVE TË NDOTURA”

Organizuar nga: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) dhe
Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH)

Do të mbahet më 27 dhe 28 maj 2024
në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës

Ndryshimet klimatike, sot konsiderohen pamëdyshje se janë shkaktuar si rezultat i aktiviteteve antropogjene, kryesisht përmes emetimit të gazeve, që e shkaktojnë efektin serrë. Ngrohja globale ka ndikim edhe në ndryshimin e sasive të reshjeve në rajone të caktuara, gjatë stinëve të ndryshme, me ç'rast shfaqen periudha të theksuara të thatësirës, rritje e numrit të valëve të nxehtësisë si dhe shfaqje e reshjeve me intensitet shumë të lartë në vende të caktuara. Pasojat e këtij fenomeni priten të jenë kritike edhe në vendet e Europës Juglindore, ku përfshihet Kosova dhe Shqipëria

Menaxhimi i burimeve ujore në të ardhmen paraqitet si një faktor shumë i rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të një vendi, sepse ai ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së njerëzve në hapësira urbane dhe jo urbane si dhe në rendimentin e të ardhurave bujqësore dhe në biodiversitetin në përgjithësi.

Si rezultat i aktiviteteve të ndryshme humane, duke përfshirë edhe aktivitetet industriale dhe ato bujqësore, ndodh ndotja e tokës, ajrit, ujrave sipërfaqësorë, lumenjëve, liqeneve e deri ujrave detarë. Zvogëlimi i shkallës së ndotjes dhe trajtimi i ujërave të tillë dhe atyre që hidhen në hapësirat urbane me teknologjitë bashkëkohore, paraqet një sfidë, por edhe kërkesë imediate, në mënyrë që në të ardhmen të sigurohen sasi të mjaftueshme të ujit të pijshëm dhe për shfrytëzim për qëllime tjera.

Qëllimi i konferencës është pjesëmarrja e ekspertëve eminentë nga Kosova, Shqipëria, rajoni dhe e më gjerë, të cilët do diskutojnë për pasojat që shkaktojnë ndryshimet klimatike, menaxhimin e pasurive ujore dhe metodat bashkëkohore të trajtimit të ujërave të ndotura.

Në kuadër të konferencës do të trajtohen, në mes tjerash, edhe këto problematika:

- Ndryshimet klimatike si pasojë e aktiviteteve antropogjene
- Burimet ujore në Kosovë dhe në Shqipëri dhe potenciali i shfrytëzimit të tyre
- Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore

Shkaktarët kryesor të ndotjes së ujërave në Kosovë dhe Shqipëri:

- Metodatat e ndryshme për zbulimin dhe eliminimin e ndotësve prej ujërave
- Senzorët e ndryshëm
- Teknologjitë e avancuara,
- Proceset e oksidimit të avancuar,
- Shfrytëzimi i ujërave të përpunuara për qëllime të ndryshme, etj.

Në këtë aktivitet parashihet të marrin pjesë së paku 50 pjesëmarrës. Gjuha e Konferencës do të jetë gjuha shqipe dhe/ose ajo angleze.

Bashkangjitur në ftesë gjeni edhe formatin e abstraktit të temës për prezantim. Afati për dorëzimin e abstraktit është 25 prill 2024. Dorëzimi i abstrakteve bëhet në adresën elektronike: fetahpodvorica@ashak.org. Abstraktet duhet të jenë në gjuhën shqipe ose atë angleze. Përzgjedhja e prezentimeve për konferencë do të bëhet në bazë të cilësisë dhe lidhjes së tyre me temën dhe autorët do të njoftohen deri më 5 maj 2024. Punimet e prezantuara origjinale do të botohen në librin e konferencës që e boton ASHAK-u me ISBN.

Këshilli organizativ shkencor:

Akademik Nexhat Daci,

Akademik Neki Frashëri,

Akademik Fejzullah Krasniqi,

Akademik Ilirjan Malollari,

Anëtar korrespondent Salih Gashi

Akademik i asociuar Besnik Baraj

Anëtar korrespondent Fetah Podvorica,

Prof. Dr. Roza Allabashi

Anëtare korrespondente Myzafere Limani

Prof. Dr. Valbona Kolaneci